

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË
SË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2017

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur e vlerësuar rolin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për sigurimin dhe kompensimin e depozitave të qytetarëve, të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë;
- Duke vlerësuar kontributin e saj në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit financiar e bankar;
- Duke njohur kuadrin ligjor dhe parimet bazë, mbi të cilat mbështetet veprimtaria e Agjencisë;
- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë agjenci, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e saj me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;

Vlerëson veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në drejtim të:

- Përmbushjes së objektivit në drejtim të përforcimit të stabilitetit financiar në vend me zgjerimin e skemës me subjekte të sistemit jobankar dhe me përfshirjen e depozitave të tregtarëve dhe shoqërive tregtare;
- Konsolidimit të infrastrukturës informatike, në funksion të një procesi kompensimi të shpejtë dhe të saktë të depozituesve në rast të një ngjarjeje sigurimi;
- Administrimit me efektivitet të mjeteve financiare, duke diversifikuar portofolin me investime në maturitet më afatgjatë;
- Angazhimit të Agjencisë në rritjen e nivelit të edukimit dhe ndërgjegjësimit të depozituesve për përfitimet dhe kufizimet e skemës së sigurimit të depozitave;
- Përmirësimit të kapaciteteve profesionale të nevojshme për përmbushjen e mandatit ligjor të Agjencisë;

Kuvendi kërkon që Agjencia e Sigurimit të Depozitave, për vitin 2018, të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Në funksion të transparencës dhe informimit, të hartojë rregulla dhe procedura të qarta për publikimin e vendimeve dhe materialeve të miratuara nga Këshilli Drejtues, duke respektuar kufizimet e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale dhe tregtare.
- Të monitorojë në vazhdimësi plotësimin e kushteve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi, nga ana e shoqërive të kursim-kreditit, në nxitje të një biznesi të shëndetshëm dhe afatgjatë të tyre.
- Të shtojë mjetet e promovimit të skemës së sigurimit të depozitave dhe të vlerësojë impaktin e fushatave promovuese të publiku i targetuar me anë të anketimeve të përvitshme.
- Të përditësojë politikat dhe procedurat operationale në drejtim të përputhshmërisë e skemës së sigurimit me parimet themelore të skemave efektive të sigurimit të depozitave.
- Të vazhdojë bashkëpunimin me anëtarët e rrjetit të sigurisë financiare dhe shoqëritë e kursim-kreditit, për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend dhe mbrojtjen e interesave të depozituesve.
- Të mirinformojë depozituesit në lidhje me masat e ndërmarra nga ana Bankës së Shqipërisë në kuadër të strategjisë së deeuroizimit.

Miraturar në datën 17.5.2018

KRYETARI
Gramoz Ruçi